



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/OPK
Nr.faq broj stranica Nr. pages	02
Nr Prot. Br Prot. Prot No.	01-1485/15
Data Datum Date	02-06-2015



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.06.2015 mori:

**V E N D I M**

**I. Ekziston konflikti i interesit në rastin me nr. AKK -03-02-110/15, për z. Xhavit Zariqi – Nënkyetar i Komunës në Ferizaj dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat.**

**II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.**

**III. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.**

**IV. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.**

**A r s y e t i m**

**I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, neni 18 (paragrafi 1 dhe 3), si dhe në bazë të vendimit Nr. 03-02-110/15, është hapur rasti nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi për zyrtarin e lartë, z. Xhavit Zariqi – Nënkyetar i Komunës në Ferizaj dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat Koperativa Bujqësore “Xhiki”.**

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (AKK-DPK-01-156/15), pas pranimit të kësaj shkrese, kemi njoftuar zyrtarin e lartë për gjendjen në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëjë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtarit të lartë z. Zariqi, i është bërë e ditur se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë nuk mund të ushtroj funksion menagjues në biznes privat, kjo për faktin se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr.04/L-051) e ndalon një gjë të tillë. Neni 15 (paragrafi 1) i këtij ligji shprehimisht thotë:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private”.*

Përkundër afateve ligjore të dhëna nga Agjencia, duke përfshirë edhe shkresën paralajmëruese (AKK-01-773/15), zyrtari i lartë nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për tu larguar nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privat në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Prandaj, duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, zyrtari i lartë z. Zariqi nuk e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Bazuar në nenin 18 (paragrafi 8) të Ligjit (Nr.04/L-051), në rast se zyrtari i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.

III. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuara në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3.

Sipas nenit 20 pika 2, “Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtari i lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund ti shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit”.

IV. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

IV. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

